



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 245/14 Prot.

Tiranë, më 02 . 07 . 2015

V E N D I M

Nr. 63 , datë 02/07/2015

Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me inspektimin e zhvilluar në institucionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar,

VËREJ SE:

Në zbatim të Vendimit nr. 22, datë 11.03.2015, "Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar", të ndryshuar me Vendimin nr. 25, datë 17.03.2015, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 22, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil", vendosa kryesisht fillimin e inspektimit për administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

Objekti i inspektimit është i përgjithshëm dhe përfshin monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe akteve nënligjore, gjatë aplikimit të gjithë instituteve të tij, si dhe arsyet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë.

Inspektimi është zhvilluar në përputhje me programin e inspektimit nr. 245/2 prot., datë 11.03.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe i është njoftuar institucionit me shkresën nr. 245/1 prot., datë 11.03.2015, "Njoftim mbi fillimin e verifikimit të shkresës dhe kërkim dokumentacioni", inspektim i cili do të fillonte në datën 17.03.2015.

Me shkresën nr. 245/3 prot., datë 18.03.2015, *“Njoftim për shtyrjen e datës së fillimit të inspektimit”*, nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kërkuar që inspektimi pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar të fillojë në datën 20.03.2015.

Në përfundim të këtij procesi, grupi i inspektimit ka hartuar projektraportin, i cili i është dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 245/7, datë 15.05.2015, *“Dërgohet projektraporti”*, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet dhe aktet administrative që i mbështesin ato.

Në vijim të procesit, nga ana e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 1581 Prot., datë 20.05.2015, është kthyer projektraporti i nënshkruar nga titullari i institucionit, së bashku me observacionet përkatëse, në lidhje me konstatimet e grupit të inspektimit, si dhe aktet administrative që i mbështesin ato.

Sa më sipër, u analizua përmbajtja e observacioneve, si dhe e provave që i shoqëronin ato duke, i krahasuan me gjetjet e grupit të inspektimit, të evidentuara në projektraport dhe qëndrimi në lidhje me to, është materializuar në pjesët përkatëse të raportit përfundimtar të inspektimit.

Nisur nga aktet administrative që na janë vënë në dispozicion nga institucioni i inspektuar, konstatohet se në zbatim të rekomandimeve të grupit të inspektimit, në lidhje me institutin e përshkrimit të punës, nga njësia përgjegjëse e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar janë marrë të gjitha masat për plotësimin e formularëve të përshkrimit të punës, sipas kërkesave të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, brenda datës 20.05.2015.

Për efekt të verifikimit të pretendimeve të ngritura në observacionet e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 245/11, datë 26.05.2015, të Komisionerit është kërkuar njohja me disa nga dokumentat e cituara në observacion, për shkak se ato nuk ndodheshin bashkëlidhur. Ky proces është realizuar në datën 01.06.2015, nëpërmjet vizitës së inspektorëve në institucion, duke u njohur me materialet e kërkuara, të cilat u vunë në dispozicion të tyre nga institucioni.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova përmbajtjen e raportit përfundimtar të inspektimit, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Rregulloren *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Nga ana e njësisë së burimeve njerëzore dhe Departamentit të Administratës Publike duhet të mbahen parasysh rekomandimet e Komisionerit, në lidhje me institutin e vlerësimit të punës, të cilat janë të materializuara në përmbajtjen e raportit të inspektimit, me qëllim që ky proces të kryhet në përputhje me procedurat ligjore dhe për të evituar subjektivizmin në nivelin e vlerësimit.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, si dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të inspektimit dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera ŠTRAKOSHA